



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

P. 490
Df. 13.12.2019

Vendim

Nr. 42, datë 13 12.2019

**Për ngritjen e grupit të punës për propozimin paraprak të
projektit të hartimit të *Enciklopedisë Shqiptare***

Mbështetur në Ligjin nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*, neni 4, pikat 16 e 17 dhe neni 19;

Referuar Statutit organik të Akademisë së Shkencave, neni 4, pikat 16 e 17 dhe neni 44, *për ngritjen e njësive të kërkim-studimit*;

1. Ngrihet grupi i punës *për propozimin paraprak të projektit të hartimit të Enciklopedisë Shqiptare*, nismë shkencore e përbashkët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, me këtë përbërje:

- Prof. dr. Emil Lafe
- Akad. Marenglen Verli
- Prof. dr. Aurel Plasari
- Akad. asoc. Ilirjan Malollari
- Dr. Arian Leka

2. Grupi i punës ngarkohet t'i propozojë Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, brenda datës 20 janar 2020:

- Një relacion analitik për gjendjen e deritashme të punës për botimin e fjalorëve enciklopedikë në Shqipëri dhe në Kosovë, si dhe për koncepte ekzistuese për një *Enciklopedi Shqiptare*;
- Projekt-marrëveshjen e bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës për *Enciklopedinë Shqiptare*;

Konceptoi:

Punoi:

- Projekt-vendimin për miratimin e nismës shkencore ndërakademike për hartimin e *Enciklopedisë Shqiptare*, pjesë e strategjisë së institucionit, me mbështetjen e Këshillit të Ministrave, bashkë me relacionin përkatës;
- Propozimin për një ndryshim nënstrukturor dhe për krijimin e një njësie kërkimore bazë pranë Akademisë së Shkencave, në funksion të projektit;
- Rekomandime për bashkëpunëtorë të përhershëm nga radhët e studiuesve të njohur në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi, në botën arbëreshe dhe në institucionet akademike dhe universitare në botë;
- Një parashikim për vëllimin e punës që do të kryhet, kalendarin dhe koston, ndarë në faza (hartimi i parimeve, stabilizimi i hierarkisë së zërave, krijimi i redaksive dhe nënredaksive, ndarja e punës dhe hartimi i zërave, të drejtat e autorit, shtypshkrimi etj.).

3. Grupi i punës ka të drejtë të organizojë, në emër të Akademisë së Shkencave, takime pune ndërinstytucionale për kryerjen e detyrës së vet.


4. Për punën jashtë ngarkesës zyrtare grupi i punës gëzon të drejtën e një shpërblimi të arsyeshëm.

5. Ngarkohet Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike dhe akad. Floresha Dado, kryetare e këtij seksioni, të krijojnë kushtet e përshtatshme dhe të mbështesin veprimtarinë e grupit të punës.

6. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të institucionit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder Gjinushi

Kryetar



Konceptoi:

Punoi: